



Asambleja

01.Nr.I.

Deçan, dt.09.12.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e parë inauguruese të Kuvendit të Komunës së Deçanit, me dt.09.12.2025.

Sot është mbajtur mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Deçanit, ku qeverisja lokale e dalë nga zgjedhjet e 12 Tetorit ka marrë mandatin e ri qeverisës, asamblistët dhe Kryetari i Komunës kanë bërë betimin solem, ku janë betuar 21 anëtarët e rinj të kuvendit nga pesë subjekteve politike, AAK-së më 11 ulëse, LDK-ja më 6 ulëse, ID-ja me 2 ulëse, LVV-ja me 1 ulëse dhe PSD-ja më 1 ulëse. Gjithashtu betimin e ka bërë edhe Kryetari i Komunës së Deçanit z.Bashkim Ramosaj, për mandatin e tij të tretë.

Të pranishëm në sallë ishin: ish kryetari i komunës z.Musa Berisha. Po ashtu në këtë mbledhje inauguruese të pranishëm ishin edhe klerik fetarë, përfaqësues të Policisë, KFOR-it, OSBE-së, përfaqësues institucionesh dhe mekanizma të ndryshëm si dhe shumë qytetarë.

Këtë seancë e hapi z.Mustafë Selmanaj, si anëtari më i vjetër i Asamblesë Komunale, duke u bazuar në nenin 42 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 35 pika 3 të Statutit të Komunës së Deçanit që i referohet seancës së parë inauguruese, i njëjti ka udhëhequr seancën deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri të Kuvendit.

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese

09 Dhjetor 2025, 10:00 – 12:15

10:00-10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.
10:15-10:30	Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës • Fjala mirëseardhëse •
10:30-10:45	Kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës • Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës • Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
10:45-11:00	• Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës

11:00-11:30	Pauzë
11:30-12:00	• Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit • Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit
12:00-12:15	Mbyllja e seancës

**Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Deçanit e mbajtur
me dt.09 Dhjetor 2025**

- **Kryesimi i mbledhjes dhe Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës**

Mustafë Selmanaj, Kryesues I seancës inauguruese e ka hapë seancën me përshëndetje për të pranishmit.

Të nderuar:

- Familje të Dëshmorëve,
- Veteran të Luftës së UÇK-së,
- Përfaqësues të Policisë së Kosovës,
- Përfaqësues të KFOR-it,
- Përfaqësues të OSBE-së,
- Përfaqësues të Bashkësive Fetare,
- Përfaqësues të Shoqërisë civile,
- Përfaqësues të mediave,
- Të dashur qytetarë dhe pjesëmarrës tjerë të kësaj séance inauguruese.

Të gjithë ju te pranishem ju dëshiroj mireseardhje dhe ju shprehë falënderimet e mia dhe të kolegëve të mi asamblast për pjesëmarrje në seancën inauguruese të Kuvendit Komunal të Deçanit, i cili ka dalë nga vota e lirë e qytetarëve, në zgjedhjet e 12 Tetorit 2025.

Anëtarëve të zgjedhur ju dëshiroj punë të mbarë.

Në bazë të Rregullores së punës së kuvendit tani duhet të bëhet verifikimi i anëtarëve të Kuvendit

Konstatoj se në bazë të nenit 46.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 38 të Statutit të Komunës së Deçanit, sipas njoftimit nga sekretaria e Kuvendit në mbledhje marrin pjesë 20 nga 21 anëtarë të Kuvendit, aq sa ka Kuvendi I Komunës së Deçanit sipas numrit të popullsisë nga regjistrimi I vitit 2024 dhe kemi kuorum për vazhdimin e séances (mungon Natyra Kuçi).

Rendin e ditës për këtë séancë e keni marrë me ftesë, dhe meqenëse është mbledhje inauguruese dhe ju ende nuk e keni dhënë betimin , ky rend dite nuk ka nevoj të qitet në votim.

• Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Kryesuesi I seancës- Propozoj që fillimisht të ngriten në këmbë anëtarët e zgjedhur të kuvendit dhe betimin solemn ta lexojmë bashkarisht dhe ta nënshkruajmë individualisht dhe ta dorëzojmë në sekretarinë e Kuvendit.

Ne vazhdim kryhet akti solemn I dhënjes së betimit me këtë tekst:

Unë, _____, ”betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

(Pas dhenjes se betimit)

Kryesuesi i seancës- Konstatoj se nga ky moment kuvendi ka legjitimitetin e plotë në ushtrimin e punëve dhe përgjegjësiqe që e presin.

• Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës

Kryesuesi I seancës- Ftoj kryetarin e zgjedhur ne zgjedhjet e 12 Tetorit z.Bashkim Ramosaj, në mandatin e tij të tretë që ta ep betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj ep betimin solemn. Me kete tekst:
Unë, **Bashkim Ramosaj**, ”betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Deçanit, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë”.

Pas dhenjes se betimit.

Kryesuesi I seancës-Konstatoj se prej ketij momenti z. Bashkim Ramosaj, në mandatin e tij të 3-të i merr të gjitha kompetencat ligjore të kryetarit të komunës së Deçanit.
Ne emer tuaj dhe ne emer tim personal kryetarit, z.Bashkim Ramosaj ia uroj detyrën në mandatin e tij të tretë duke i dëshiruar punë të mbarë dhe shumë suksese, e njëkohësisht e ftoj Kryetarin për një fjalë rasti.

• Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Të nderuar qytetar të Komunës së Deçanit, të respektuar anëtarë të Kuvendit më lejoni të ju përshëndes e të ju përgëzoj për mandatin tuaj si rezultat I besimit të qytetarëve ndaj jush. Të nderuara familje të dëshmorëve e martirëve të kombit, të burgosur politik, invalid e veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, I nderuar Gjeneral Haradinaj, zoti Geci, I nderuar Imam, I nderuar ish kolegu jonë Musa Berisha, I nderuar Nasim, të nderuar të gjithë ju përfaqësues të mediave , të OSBE-së, shoqëri civile, po më vjen mire që këtu I shoh edhe disa institucione tepër të rëndësishme tonat, ansamblin e qytetit, zjarrëfiksat, kompaninë Higjiena, Policinë e Kosovës, përfaqësues të

KFOR-it. Jam sot këtu, para jush, me krenarinë që çdo kuj ja jep ky qytet, krenarinë që buron nga njerëzit e ndershëm, bujar e punëtorë të këtij qyteti, krenari deri në mburrje, me të drejtë që ne trashëgojmë edhe nga paraardhësit tonë që sakrifikuan e u rropatën shumë që ky qytet të jetë I tillë dhe ta ketë historinë dhe krenarinë e tij.

Qytetar të nderuar, duke qenë përjetësisht mirnjohës për besimin tuaj, do të jem shërbëtor I përulur në qëllim të jetësisht të qëllimeve tona të përbashkëta, poashtu në këtë sallë, jam përballë edhe prindëve të mi, nanës e babës, që I falënderoj dhe jam mirënjohës për gjithë atë që kanë bërë për ne, mirënjohës që ngritët një edukatë për mua, motrat dhe vëllëzërit e mi, njëkohësisht e dashur bashkëshorte ime, mirënjohje për çka bënë për mua dhe për fëmijët tonë, poashtu një mirënjohje dhe falënderim të veçantë për kolegët e mi me të cilët rrugëtoj e punoj, e njëkohësisht I falënderoj për shërbimin e bërë qytetarë të kësaj komune sepse janë edhe familja ime e dytë dhe janë shërbëtorë të njerëzve të këtij qyteti. Si kryetar I komunës, si qytetar I këtij vendi do vazhdoj të flas me punë, sepse ky ishte edhe sllogani ynë, sllogani I Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dhe në këtë pjesë nuk do bëjmë kompromis, do vazhdojmë me përkushtim të punojmë për zotimet tashmë të deklaruara për çdo sektor të jetës, për arsimin, për shëndetësinë, për mirëqenien, për infrastrukturën, zhvillimin ekonomik e turizmin, kulturën, rininë, sportin, trashëgiminë. Duke qenë I bindur në idenë që po bëjmë punë të ndershme, e të mirë për këtë qytet, vlerësoj se do jemi një qytet model e kampion brenda shtetit të Republikës së Kosovës. E njëkohësisht qytetar të dashur të Komunës së Deçanit, të nderuar ju që keni marrë mandate e besim të qytetarëve gjatë krejt rrugëtimit tonë duhet ta kemi parasysh një qytet I cili nuk ka ekzistuar në vitin 1999, një qytet që është përballë me shumë mungesa, një qytet I cili ka rilindë jetën, e këta banorë e kanë rilindë jetën në këtë qytet, ende sot vazhdojmë të jemi përfaqësues të shumë personave që janë të zhdukur e trupat e tyre nuk janë gjindur, ende sot vazhdojmë të kemi ëndrra të mëdha për jetën tonë dhe familjet tona, për standartin I cili duhet të ndërtohet, për mirëqenien e çdo familje në këtë vend. Andaj kërkoj nga ju që të bëhemi model i mirë i bashkëpunimit dhe arritjes së rezultateve që i kemi të përcaktuara. Duke ju falënderuar të gjithë juve pasi që jemi edhe në një cikël tjetër zgjedhor, ju lus që të gjithë ju, pavarësisht mendimeve dhe përcaktimeve politike që keni, ta nderojmë këtë qytet duke u sjellur njerëzishëm e me qytetari në kë vend. Falënderit prej të gjithë juve.

Pas fjalës së rastit të Kryetarit të Komunës, (Kryesuesi I mbledhjes) ju bënë kërkesë te pranishmëve që bashkërisht të marrin pjesë në koktelin e organizuar ne objektin e komunes enkas per mbledhjen inauguruese

Kryesuesi i seancës -I lus anëtarët e Kuvendit që pas një pauze prej 15 minutave të kthehen në sallë për të vazhduar me punimet e kuvendit.

Pas pause

Fillimisht Natyra Kuçi, e cila nuk ka qenë prezent në sallë në kohën e dhënies së betimit nga anëtarët e kuvendit, ka bërë dhënien e betimit solemn para kryesuesit të seancës

• Zgjedhja e Kryesuesit te Kuvendit.

- Formimi I Komisionit per udhëheqjen e procedurave të zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i seancës-Komisioni duhet te formohet në përbërje të 3 anëtarëve që zgjidhën nga radhët e anëtarëve të kuvendit, ku përfaqesohen subjektet politike sipas numrit të ulëseve që kanë, dy nga pozita dhe një nga opozita.

Formohet komisioni për zhvillimin e procedurave të zgjedhjes së Kryesuesit në këtë përbërje:

Florim Mataj -AAK, Kryesues i Komisionit, Laureta Zejnaj AAK anëtare dhe Albesa Cacaj-LDK, anëtare e komisionit.
Kjo përbërje e Komisionit miratohet njëzëri.

Propozimet për Kryesues të Kuvendit.
Kryesuesi i seancës, Mustafë Selmanaj - Ftoj perfaqesuesit e subjekteve politike ne kete Kuvend që të bëjnë propozimin për Kryesues të Kuvendit.

Rifat Stojkaj-në emër të AAK-së fillimisht falënderim për qytetarët e Komunës së Deçanit dhe urime për anëtarët e kuvendit, në emër të AAK-së propozon Hajdar Sutaj për Kryesues të Kuvendit.

Shkumbin Demaliaj- në emër të ID urime kësaj përbërje të kuvendit dhe dëshiroj punë të mira për Deçanin, unë kam konkuruar në këto zgjedhje bashkë me Rrezarta Hadergjonaj për subjektin Iniciativa Demokratike, në emër të ID e propozoj për Kryesuese të Kuvendit Rrezarta Hadergjonaj. Rrezarta Hadergjonaj deklarohet se nuk e pranon propozimin për nominim të saj për pozitën e Kryesuesit të Kuvendit.

Hyri Dobrunaj – urime për të gjithë përbërjen e këtij kuvendi që ka dalë nga zgjedhjet e 12 tetorit, por kam vërejtje që nuk e bëtë një minut heshtje për z.Mehmet Bojkaj, i cili ka vdekur para pak ditëve, e që ka qenë Kryetari i parë i Komunës dhe i Kuvendit të Komunës i zgjedhur pas lufte, ndërsa si LDK deklaroj se nuk kemi propozim për kryesues të kuvendit.

Kryesuesi I seancës - e lus komisionin dhe sekretarinë për përgaditjen e fletëvotimeve.

Kryesuesi I seancës, Mustafë Selmanaj-Ftoj komisionin e votimit qe fillimisht te verifikoj pjesëmarrjen e anëtarëve të kuvendit prezent dhe të filloj me procedurën e votimit

Procedura e zgjedhjes se Kryesuesit te kuvendit.

Në vazhdim është krye procedura e votimit, ku sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit bëhet me votim të fshehur.
Kryesuesi i Komisionit, Florim Mataj i fton me radhë të gjithë anëtarët e kuvendit për të marrë fletëvotimin dhe bërë votimin e fshehtë.

Pas përfundimit te procedurës se votimit, numërimi i votave nga komisioni është bërë ne mënyrë te hapur.

Pas kryerjes së raundit të parë të votimit, Komisioni ka konstatuar se z.Hajdar Sutaj, kandidat i vetëm për kryesues te kuvendit ka marrë këto vota: 12 vota “për” 3 “kundër”, 6 “të pavlefshme”.
z.Hajdar Sutaj, zgjedhet Kryesues i Kuvendit te Komunës së Deçanit, në mandatin e tij të dytë, me 12 vota “për” 3 “kundër”6 “të pavlefshme”.

Kryesuesi I seancës- Konstatoj se në bazë të nenit 41.4 te Ligjit Nr.03/L-040 për Veteqeversje Lokale dhe nenit 36 pika 4 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit ka bërë zgjedhjen e kryesuesit te Kuvendit z. _Hajdar Sutaj, të cilin e ftoj për një fjalë rasti dhe për kryesimin e mbledhjes.

- **Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit.**

Në vazhdim Kryesuesi i sapozgjedhur i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj para të pranishmëve ka mbajtur një fjalë përshëndetëse.

I nderuari Kryetar z.Bashkim Ramosaj
Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Ju falënderoj sinqerisht për besimin që më dhatë. Ky besim është obligim dhe përgjegjësi ndaj institucionit të Kuvendit të Komunës, dhe secilit qytetar të komunës sonë.

Në këtë fillim të fjalës, dua të shprehë mirënjohjen, respektin dhe nderimin me të lartë për dëshmorët e Kombit, familjet e tyre, invalidët e luftës çlirimtare, veteranët e UÇK-së, të burgosurit politik, familjet e të zhdukurve, dhe gjithë ata burra e gra, që nder breza, me luftën dhe sakrificën e tyre, u bënë themel i lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë, duke na mundësuar të kemi shtetin e lirë e të pavarur, institucionet e Republikës, duke pasur mundësi të zgjedhim dhe të zgjidhem, si në krejt shtetet e lira e demokratike të botës!

Premtoj se do të udhëheq me transparencë dhe gjithmonë duke vënë interesin e institucionit dhe interesin qytetar mbi çdo interes tjetër.

Do të jem i hapur për bashkëpunim me të gjitha grupet, pavarësisht bindjeve politike, sepse Kuvendi është institucioni ku duhet të bashkohemi për të mirën e përbashkët.

Angazhimi im do të jetë që vendimmarrja të jetë e drejtë, profesionale dhe në shërbim të zhvillimit të komunës dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Shfrytëzoj rastin të uroj Kryetarin z.Bashkim Ramosaj për besimin e marrë, dhe fillimin e mandatit të ri, duke i dëshiruar suksese e punë të mbarë!

Gjithashtu urimet me të mira, për besimin e fituar nga qytetarët gjithë ju kolegë e kolege të Kuvendit të Komune, të përfaqësuar nëpërmjet subjekteve politike!

Nga sot për mua, edhe për ju, fillon etapë e re, me përgjegjësi të reja, duke lënë pas gjuhen e fushatës, duke treguar maturi, unitet, bashkëpunim, për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Deçanit, e sidomos brezave të ri, pjesës më vitale dhe më shpresëdhënëse të vendit tonë!

Ju faleminderit edhe njëherë për besimin dhe ju siguroj se do ta kryej këtë detyrë me nder dhe përkushtim maksimal.

Faleminderit!

Mbyllja e seancës.

Procesmbajtëse
Dyke Llojuni



Kryesuesi i seancës
Mustafë Selmanaj

